



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorazunt Prilijeno/Prodato Received/Delivered	15-08-2023	3 viti god year	
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPITESHUK	5678	2023	114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.944/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani Kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.Nr.944/2023 të datës 11.07.2023, të parashtruar nga grup ankuesish, me adresë

kundër organit të punësimit Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në çështjen juridike "Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës", duke vepruar në pajtim duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.Nr.944/2023 të datës 11.07.2023, të parashtruar nga grup ankuesish.

A r s y e t i m

Ankuesit të gjithë të punësuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, përmesë e-mailit më datë 11.07.2023, kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 5110/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër Njoftimit të datës 30.08.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror për mos ripërtëritje të Kontratave, Akt Emërimeve nga ana e institucionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.07.2023 ka dërguar kërkesën për

përgjigje në ankesë tek Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, ndërsa Këshilli më datë 26.07.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga e njëjta me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 5110/2023 të datës 11.07.2023 të parashtruar nga grup ankuesish në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-mail nga për ankesa.kpmshck@rks-gov.net i datës 11.07.2023; Vendim i Komisionit për Ankesa i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror me numër KA-Nr.15/2022 i datës 13.10.2022; Akt Emërim i me Nr.0591 i datës 24.09.2021; E-mail nga për etj. i datës 30.08.2022; E-mail nga për ankesa.kpmshck@rks-gov.net i datës 14.07.2023; E-mail nga ankesa.kpmshck@rks-gov.net për i datës 11.07.2023; Autorizimin nga ankuesit për i datës 11.07.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.07.2023; E-mail nga për i datës 20.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 26.07.2023; E-mail nga për etj. i datës 21.07.2023; Vendim për themelimin e Aktit të Emërimit të me numër prot.0590 i datës 24.09.2019; Përshkrimi i vendit të punës për pozitën Inxhinier i divizionit të Navigimit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror i datës 23.09.2019; Ndryshim dhe plotësimi i Aktit të Emërimit për me numër prot. 0426 i datës 19.10.2021; E-mail nga per G.B. i datës 18.10.2021; Vendim për vazhdimin e Aktit të Emërimit për me numër prot. 0164 i datës 01.04.2022; Ndryshim dhe plotësimi i Aktit të Emërimit për me numër prot.0171 i datës 01.04.2022; Akt Emërim i me numër prot.0593 i datës 24.09.2019; Vendimin për themelimin e Aktit të Emërimit për me numër prot.0592 i datës 24.09.2019; Ndryshim dhe plotësimi i Aktit të Emërimit të me numër prot.0427 i datës 19.10.2021; E-maili nga për i datës 18.10.2021; Vendim për vazhdimin e Aktit të Emërimit të me numër prot.0162 i datës 01.04.2022; Ndryshim dhe plotësimi i Aktit të Emërimit të me numër prot.0172 i datës 01.04.2022; Akt Emërim i me numër prot.0589 i datës 24.09.2019; Vendimi për themelimin e Aktit të Emërimit të me numër prot.0587 i datës 24.09.2019; Ndryshim plotësimi i Aktit të Emërimit të me numër prot.0428 i datës 19.10.2021; E-mail nga për i datës 29.09.2021; Vendimin për vazhdimin e Aktit të Emërimit të me numër prot.0155 i datës 30.03.2022; Ndryshim dhe plotësimi i Aktit të Emërimit të me numër prot.0156 i datës 31.03.2022; Akt Emërim i me numër prot.0597 i datës 24.04.2019; Vendimin për themelimin e Aktit të Emërimit të me numër prot.0596 i datës 24.09.2019; Ndryshim dhe plotësimi i Aktit të Emërimit të me numër prot.0429 i datës 19.10.2021; Vendimin për vazhdimin e Aktit të Emërimit të me numër port.0163 i datës 11.04.2022; Ndryshim plotësim i Aktit të Emërimit të me numër prot.0173 i datës 01.04.2022; E-mail nga për etj. i datës 30.08.2022; Ankesë e ankuesve drejtuar Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror me numër protokollit 04 i datës 30.09.2022; Konkursi i shpallur nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror me numër reference: ASHNA/REK/015-2019 i datës 17.04.2019; E-mail nga për i datës 09.10.2019; E-mail nga për i datës 02.08.2023; E-maili nga për i datës 01.08.2023; E-mail nga për i datës 01.08.2023; E-mail nga për i datës 09.03.2021; E-mail nga për i datës 02.03.2021; E-mail nga për etj. i datës 20.05.2021; E-mail nga info.dmzp për i datës 19.05.2021;

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil **nuk është kompetentë** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga grup ankuesish **Sepse**

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit me numër protokollit 0171 të datës 01.04.2022 është i punësuar në pozitën e punës "Inxhinier" në Divizionin e Navigimit në Departamentin Teknik, ankuesi

sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit me numër protokolli 0173 të datës 01.04.2022 është i punësuar në pozitën e punës "Inxhinier" në Divizionin e Survejimit në Departamentin Teknik, ankuesi Edon Shaqiri sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit me numër protokolli 0172 të datës 01.04.2022 është i punësuar në pozitën e punës "Inxhinier" në Divizionin e Navigimit në Departamentin Teknik dhe ankuesi Ardit Bibaj sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit me numër protokolli 0156 të datës 31.03.2022 është i punësuar në pozitën e punës "Inxhinier" në Divizionin e Survejimit në Departamentin Teknik.

Ankuesit me datë 30.09.2022 me numër protokolli 0546 kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror kundër Njoftimit të datës 30.08.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror për mos ripërtëritje të Kontratave, Akt Emërimeve nga ana e institucionit. Ndërsa me datë 13.10.2022 me numër KA-Nr.15/2022 Komisioni për ankesa në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesat e ankuesve dhe ka lënë në fuqi njoftimin e datës 30.08.2022 për mos ripërtëritje të Kontratave, ku të njëjtit kanë qenë të udhëzuar me Këshillë juridike se pala e pakënaqur mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Po ashtu në përgjigjen e datës 26.07.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është theksuar fakti se statusi i të punësuarve në ASHNA nga ana e DMZP-së është kategorizuar si Nëpunës të Shërbimit Publik.

Ankuesit kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër Njoftimit të datës 30.08.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror për mos ripërtëritje të Kontratave, Akt Emërimeve nga ana e institucionit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka gjetur se të punësuarit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, bazuar në e-mailin e datës 20.05.2021 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror kanë statusin si Nëpunës të Shërbimit Publik dhe Nëpunës Administrativ dhe Mbështetës, si rrjedhojë pozitat e ankuesve nuk janë pozita të shërbyesit civil ashtu siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përkatësisht me nenin 2 është përcaktuar se; "...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike. Ndërsa në nenin 2 paragrafi 4 po të këtij ligji është përcaktuar se : Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.

Pasi që pozitat e ankuesve hynë në kategorinë e Nëpunësve të Shërbimit Publik ,ndërsa në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me faktin se konstaton jo kompetencën në këtë lëndë përkatësisht ankesë dhe ndërlikur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës të nëpunësve të shërbimit publik ju referua Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përkatësisht nenit 24 paragrafi 4, ku parashihet: *"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente"* dhe nenit 74 të po të njëjtit ligj ku shprehimisht parashihet: *"1.Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet të punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankimit e kanë dhe kandidatët në procedurën e konkurrimit.2.Ankimimi paraqitet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit. 3.Shqyrtimi i ankesave është në kompetencën e Komisionit të Ankesave. Komisioni i Ankesave krijohet:3.1. në çdo administratë të institucionit të shërbimit publik;3.2.në çdo ministri për administratën e njësisë të Shërbimit Publik në kompetencë të administratës shtetërore; dhe 3.3.në çdo komunë për nëpunësit e administratës së njësisë së shërbimit publik në kompetencë të komunës. 5.Ankesa shqyrtohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga paraqitja e saj. Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente"*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.944/2023

Çlirim Zeka

  
Procesmbajtës

Eshref Shabani

  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesi grup ankuesish;
- Drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Arkivit të KPMSHCK-së

